



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIK MALLAKASTËR

Ballsh më, 27.04.2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Mallakastër. Kryesues i mbledhjes është Z. Nexhmi Sulaj. Ora e mbledhjes: 14:00. Kryesuesi i mbledhjes deklaroi kuorumin prej 11 anëtarësh. Të pranishëm nga administrata: Znj. Etilda Dishaj, Z. Nertil Sakaj, Znj. Kleidja Hoxhaj, Z. Ledjan Shehaj.

Kryetari i Këshillit e hap mbledhjen me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 25.03.2026.
3. **Projektvendim Nr.22:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.23:** Për miratimin e rregullores të Komisionit Këshillimor për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Mallakastër.
5. **Projektvendim Nr.24:** Për miratimin e anëtarëve të Komisionit Këshillimor për titujt vendor të nderit, emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Mallakastër.

Kush është dakord me këtë rend dite? E hedhim në votim, votojnë 11 pro, 0 kundër, 0 apstenim. Miratohet.

Kalojmë te pika 2, lexohen vendimet e mbledhjes datë 25.03.2026.

**Vendim Nr.14:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

**Vendim Nr.15:** Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare Z.Gëzim Shehaj, banor i lagjes Zhupanat, fshati Kutë, Nj.Ad. Kutë, Bashkia Mallakastër, banesa (dy katë) e të cilit është dëmtuar si pasojë e një shkarkese elektrike (rrufe) rënë më datë 15.02.2026.

**Vendim Nr.16:** Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare Z.Rrapo Myftaraj, banor i fshati Ninsh, Nj.Ad. Fratar, Bashkia Mallakastër, banesa (një katë) e të cilit është dëmtuar si pasojë e rënies së zjarrit më datë 01.03.2026.

**Vendim Nr.17:** Për miratimin e transferimit të përkohëshëm të nxënësve të shkollës 'Ismail Klosi', Ballsh.

**Vendim Nr.18:** Për miratimin e tavanëve përgatitore për programin buxhetor afatmesëm 2027-2029.

**Vendim Nr.19:** Për një ndryshim në VKB Nr.50, datë 23.12.2025 "Për miratimin e nivelit të agave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026, të ndryshuar.

**Vendim Nr.20:** Për miratimin e programit të transparencës për Bashkinë Mallakastër.

**Vendim Nr.21:** Për disa shtesa në vendimin Nr.45, datë 23.12.2025 'Për miratimin e listës së përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026'.

Klojmë në pikën tre të rendit të ditës; projektvendim Nr.22: Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

Z. Lefter Rabiaj: - Shikoj një rënie nga buxheti vendor dhe rritje të buxhetit qendror.

Znj. Kleidja Hoxhaj: - Ato që janë fitues në sistemin qendror, dalin nga skema 6% të sistemit vendor.

Z. Lefter Rabiaj: - Por nuk duhet t'i ishim më përpjestimi i drejtë?

Znj. Kleidja Hoxhaj: - Jo, sepse buxheti i qendrorit është i specifikuar.

Hidhet në votim, votojnë 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën 4; projektvendim 23: Për miratimin e rregullore të Komisionit Këshillimor për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Mallakastër.

Z. Lefter Rabiaj: - A ka pasur ndonjë rregullore deri më tani dhe këtu thuhet deri në 2 tituj nderi për një vit, por vjet na keni sugjeruar tre dhe janë tre tituj nderi.

Z. Qerim Ismailaj: - Kemi pasur një komision për shqyrtimin e dhënieve të titujve të nderit, me bazë të V.K.M kemi ngritur rregulloren, por do të bëjmë këtë sqarim dhe rregullim për të qenë konform ligjit. Kurse ne sugjerimet do t'ju paraqesim sipas kërkesëve që vijnë, nuk mund t'i lëm pa shqyrtim dhe kalim në këshill të gjitha kërkesat që vijnë për dhënie titulli qytetar nderi.

Z. Nertil Sakaj: - Do ta korrigjojmë për në vendim, për të qenë të saktësuar dhe konform ligjit.

Z. Qerim Ismailaj: - Është për titujt e veçantë të nderit. Kjo rregullore është menduar dhe për një arsye tjetër, për funksionimin edhe për sistemin e adresave, dhe kjo do të ndihmojë komisionin në hapat që do të ndjekim për emërtimin e të paktën 5 segmenteve rrugore që janë pa emërtuara në B.M, përbërja e komisionit është me projektvendimin pasardhës. Ne duhet sistemi i adresave, për të bërë edhe sistemin me tabela dhe sinjalistikë.

Ka pyetje tjetër për këtë? E hedhim në votim, votojnë 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratohet.

Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës; projektvendimi nr. 24: Për miratimin e anëtarëve të Komisionit Këshillimor për titujt vendor të nderit, emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Mallakastër.

Z. Qerim Ismailaj: - Dua të bëj një sqarim, që në këtë projektvendim do ndryshojmë pikën 6 dhe 8. Në bazë të ligjit dhe V.K.M-ve përkatëse, komisioni shqyrton dhe menaxhon dokumentacionet dhe i paraqet dokumentat e plota në bashki për të realizuar një projektvendim i cili kalon në këshill për miratim.

Në komision janë: shefi i kabinetit, drejt. e kulturës, sek. këshillit si një urë lidhëse midis bashkisë dhe këshillit dhe dy zonjat e nderuara që janë mësuese dhe të cilat kanë qenë pjesë e komisionit këshillimor për titujt e nderit. U mendua që mund të kishim figura të tjera nga jashtë, por menduam që duhet të jenë aktiv për realizimin e dokumentave.

Prof. Lefter Rabiçaj: - Për sa i përket komisionin, i lind e drejta drejtorisë juridike për listën e komisionit? Dhe pse nuk ka një jurist ky komision, jo se kam gjë me emrat konkretë.

Z. Qerim Ismailaj: - Për pjesën e njohjeve juridike është sekretari këshillit dhe drejtoresha e kulturës. Çdo shkresë nga komisioni kalon në zyrën juridike që përcillet për shembull të autoritetit për ish sigurimin e shtetit për informacion dosjesh, pastaj përgjigjia që vjen shqyrtohet nga komisioni, i cili në bazë të përgjigjes harton një relacion dhe ia dorëzon drejtorisë juridike e cila pastaj harton dhe projektvendimin.

Z. Lefter Rabiçaj: - Marr shkas, për këtë që them, nga një kërkesë që erdhi para një viti për një qytetar nga Rromësi.

Z. Qerim Ismailaj: - Po dokumentat që u paraqitën juve, u lanë së bashku me përgjigjen që erdhi nga ish sigurimi i shtetit, plus ai ishte përmendur në një process, por nuk ishte dënuar, kështu që u la në dorën tuaj për të vendosur.

Z. Armand Hasanbashaj: - Ky komision do bëjë renditjen në bazë të kërkesave që vijnë për tituj dhe do vendos ky komision se cilat do jenë ato dy kërkesa që duhet të shqyrtohen nga shumë që mund të vijnë?

Z. Qerim Ismailaj: - Jo, asnjë komision nuk bën renditje, në dokumentacion mund të jenë p.sh tre emra për emërtimin e një rruge dhe është këshilli ai që merr vendim.

Z. A. Hasanbashaj: - Çdo kërkesë për një kandidaturë për tituj nderi do paraqitet në këshill, komisioni thjesht do bëjë dokumentacionin?

E hedhim në votim, votojnë 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim. Miratohet.

Z. Nexhmi Sulaj: - Ka ndonjëri pikë të ndryshme për diskutim.

Z. Adrian Hazizaj: - Sinjalistika, për tabelat.

Z. Qerim Ismailaj: - Ju thashë, do emërtuar në fillim rrugët pastaj do bëhen tabelat, dhe çdo gjë tjetër për sinjalistikën.

Z. Armelin Agaj: - Pensionistët e qytetit kërkojnë një ambient ku të kalojnë mbasditen.

Z. Qerim Ismailaj: - Brenda qytetit po mendojmë aty afër gjendjes civile, por kemi pengesë në ambientet e zyrave partiake. Ambienti në qendër është shumë i vogël, kurse te ish gjimnazi është larg, kurse te pallati i kulturës ndodhin dëmtime, nëse keni sugjerime më thoni.

Faleminderit për prezencën në mbledhje sot!

*Sekretar Këshilli  
 Linaida Ahmetaj*